



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:067101

Datë: 29.01.2025

Numri i dokumentit: 06776001

P.nr.1288/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal, gjyqtarja e vetëm gjykuese Naime Krasniqi Jashanica, me zyrtaren ligjore/ praktikante Medina Zeqiri, në çështjen penale kundër të pandehurit Bali Krasniqi, për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së*, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.1967/23 të dt.20.06.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 29.01.2025, në praninë e prokurorit të shtetit Paulin Pashku, të pandehurit Bali Krasniqi me mbrojtësin e tij Av. Liridon Kutlllovci, me datë 29.01.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit:

BALI KRASNIQI, nga i ati H., e ëma R. e gjinisë V., data e lindjes..., G. KK Prishtinë ku dhe banon, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE

Ekziston dyshimi i bazuar mirë se me datë 20.07.2022, rreth orës 16:25, në rrugën “Ahmet Krasniqi” në Prishtinë, përderisa Njësia e Policisë Patrolluese kanë qenë duke patrolluar në rrugën në fjalë, kishin ndaluar veturën e tipit “AUDI”, ngjyrë hiri, me targa ..., të cilën e drejtonte tani i pandehuri Bali Krasniqi, ku gjatë kontrollimit të veturës, në derën e pasagjerit të veturës të cilën e drejtonte i pandehuri, janë gjetur 100 fishek të llojit Luger 9x19 mm, të cilët i pandehuri pa autorizim dhe leje valide i ka mbajt në pronësi dhe kontroll në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, të cilat fishek atëherë janë sekuestruar nga ana e policisë.

-Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43,44, 69, 70, dhe nenit 185 par.2 dhe 184 par.1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 360, 364, 449, 452 të KPPK-së.

E GJYKON

TË AKUZUARIT: Bali Krasniqi i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumë prej 500 (pesëqind) euro, i akuzuari është i obliguar që t'i paguaj në afatin prej 15 ditësh por jo me gjatë se 3 muaj, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Ne vështrim te nenit 366, par.3 të KPRK-së, konfiskohen 100 fishek të llojit Luger 9x19 mm.

Obligohet i pandehuri që të paguajë në emër paushallit gjyqësor shumën prej tridhjetë (30) euro dhe në emër të Fondit për Kompensimin e viktimave të Krimit shumen prej njëzetë (20) euro, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e arsytimit të aktgjykimit

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 20.06.2024, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1967/23, ndaj të pandehurit Bali Krasniqi, për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Kompetenca e gjykatës

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestarë, në vështrimin e aktakuzës ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore. Sa i përket kompetencës territoriale gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i KPPRK-së, kompetencë territoriale për tu gjykuar një çështje juridiko-penale, ka gjykata në territorin e së cilës është kryer apo është tentuar të kryhet vepra penale, apo në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja. Në rastin konkret vepra penale është kryer në Prishtinë, andaj Gjykata Themelore në Prishtinë ka kompetencën territoriale në gjykimin e kësaj çështje. Duke vlerësuar kompetencën lëndore, gjykata konstaton se me qenë se vepra penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, parashihet dënim me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet. Departamenti i përgjithshëm ka kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje.

Shqyrtimi fillestar

Gjyqtarja e vetme gjykuese ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 29.01.2025, në të cilën seancë i pandehuri Bali Krasniqi, pasi që është njoftuar me të drejtat e tyre, i është lexuar aktakuza dhe gjyqtarja vetme gjykuese është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ku i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranojë fajësinë lidhur me veprën e cila u vihet në barrë.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi që është në pajtim të plotë me nenin 242 të KPPRK-së, dhe po ashtu është në harmoni të plotë edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, andaj i propozoj gjykatës që ta miratoj pranimin e fajësisë dhe të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit, lidhur me sanksionin penal i propozoj Gjykatës se te merre parasysh rrethanat lehtësuese se i

pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale, ndërsa rrethanat rënduese ti vlerësoj me te kaluarën kriminale te te pandehurit dhe shkresat e tjera te lëndës.

Mbrojtësi i te pandehurit Av. Liridon Kutllovci gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, ka deklaruar se pas konsultimeve që i kemi bërë me të mbrojturin tim e që e ka kuptuar peshën e veprës dhe i ka kuptuar edhe lehtësitë që mund ti ofrohen me rastin e pranimi të fajësisë e ka pranuar me vullnetin e plotë fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon prokuroria, duke pasur parasysh sjelljen e mbrojturit tim ndjesinë dhe keq ardhjen që ka pasur lidhur me veprimin e bërë, keqardhje të cilën e ka shpreh edhe gjatë marrjes në pyetje nga policia si dhe duke pasur parasysh pendimin e sinqertë të tij lidhur me këtë rast i propozojmë gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit shqiptimit të dënimit gjykata të vlerësoj të gjitha rrethanat lehtësuese sjelljes korrekte të tij gjatë gjithë procedurës, pendimin e tij të thellë dhe pranimin e veprës dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepër të njëjtë, andaj duke vlerësuar gjitha këto rrethanë i propozoj gjykatës shqiptimin e dënimit sa më të butë, e që do të arrinte qëllimin e dënimit të paraparë me nenin 88 të KPRK-së.

I pandehuri Bali Krasniqi në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar përkrah fjalën e te mbrojturit të tij.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Gjykata, duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 242 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimi të fajësisë nga të pandehurit.

Provat që janë administruar dhe vlerësuar

Gjykata, pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar, nuk është lëshuar në administrimin e provave, mirëpo me rastin e pranimi të fajësisë ka konstatuar se pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës si: Raporti fillestar i policit ,Raporti i shpejt, Deklarata e të dyshuarit, Vërtetimin mbi konfiskimin e gjësendeve, të dt. 20.07.2022, Lista e dëshmitë – zingjiri i ruajtjes, E kaluara kriminale dhe informacionet në procedurën paraprake si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit gjykata ka pasur parasysh se vepra penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par. 1 për të cilën akuzohet i akuzuari është e sanksionuar, me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet, andaj gjykata duke u bazuar por mos u kufizuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësues ndaj të pandehurit ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të pandehurit se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, si dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur. Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me këtë

dënim te shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit si në nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Arsyet lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 450 paragrafi 2, pika 2.6 e lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të KPPRK-së, e ngarkoi të akuzuarin lidhur me shpenzimet e procedurës, duke e obliguar të njëjtin që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30.00 euro. Ndërsa konform nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të akuzuarin të paguajë shumën prej 20 euro, në emër të taksës për Programin e Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Gjykata vendimin për konfiskim të armëve e mori në bazë të nenit 366, par.3 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.1288/24, data 29.01.2025

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Naime Krasniqi Jashanica

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga momenti i marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palët.